



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. I prot. 2142 Më 18.07.18
Br. prot. Dt. 20
RAHOVEC - ORAHOVAC

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec/Opština Orahovac/Rahovec Municipal



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

DATE /A:	18.06.2018
PËR/ZA/TO :	Z.Afrim Dina,Kryesus i Kuvendit Komunal të Rahovecit
REFERENC-Ë::	01/309/18
NGA/OD/FROM:	Z.Artan Asllani,Drejtor për Ekonomi,Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë



Informatë rreth dëmeve në amvisëri dhe ekonomi familjare:

Pas vërsimeve që kanë ndodhur në komunën e Rahovecit me datë: 14,15 dhe 16 qershor 2018, është formuar komisioni nga Kryetari i komunës Z.Smajl Latifi me **Nr.01/309/18**, datë: 18.06.2018 për vlerësimin e dëmeve në amvisëri dhe ekonomi familjare të shkaktuar nga breshëri dhe shirat e rrëmbyeshëm me datë: 14,15 dhe 16 qershor 2018.

Komisioni në përbërje të plotë pas daljes në teren i ka vizituar të gjitha vendbanimet në veçanti vendbanimet në të cilët ka pasur të reshura dhe zonat që janë prekur më së shumti. Pas përfundimit të vizitave në teren janë marrë të dhënat për dëmet e shkaktuara, komisioni konstaton se vendbanimet më të dëmtuara nga vërshimet janë Krusha e Madhe dhe Celina, ndërsa vendbanimet tjera si Brestoc, Hoqë e Vogël, Fortesë, Xërxe dhe Malësi e Vogël dëmet e shkaktuara janë më të vogla.

Komisioni konstaton se si pasojë e vërshimeve dhe shirave më së shumti janë prekur amvisërit (dëmet kryesisht janë shkaktuar nëpër bodrume të shtëpive) si pasojë e daljes së lumenjëve nga shtrati, dëmet ka pasur edhe në disa biznese të komunës së Rahovecit. Vlera e përgjithshme e dëmeve të shkaktuar nga vërshimet kap shumën prej: **248,560.00 €**

Me respekt,